



**Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo**



**Komuna e Gjiçanit
Opština Gnjilane
Municipal Gjiçan
Gilan Belediyesi**

DREJTORIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

Bazuar në Nenin 14 të Rregullores të Ministrisë së Financave Nr.: 04/2017, mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport shpall:

Udhëzimet për Aplikantët

Data e hapjes së thirrjes publike: 11.02.2022.

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve: pesëmbëdhjetë (15) ditë pune dhe përfundon me datën 04.03.2022, ora 16:00.

Përmbajtja

1. THIRRJE PUBLIKE PËR MBËSHTETJE FINANCIARE PUBLIKE TË INDIVIDËVE DHE OJQ-VE NË PROJEKTET ME AKTIVITETE KULTURORE, SPORTIVE, DHE RINORE NË KOMUNËN E GJILANIT	3
1.1 Përshkrimi i problemit, i cili synohet të adresohet përmes kësaj thirrje publike.....	3
1.2 Fushat e përkrahjes së projekteve:.....	3
1.3 Objektivat e thirrjes publike.....	3
1.4 Vlera e planifikuar për projektet kulturore artistike.....	4
2. KUSHTET FORMALE TË THIRRJES PUBLIKE.....	4
2.1. Kush mund të aplikoj?	4
2.2 Shpenzimet e pranueshme që do të financohen për këtë thirrje publike	4
2.2.1. Shpenzimet e drejtpërdrejta të pranueshme.....	4
2.2.2. Shpenzimet e papranueshme.....	5
3. SI TË APLIKONI?.....	5
3.1 Dokumentacioni i detyrueshëm.....	5
3.2 Ku ta dorëzoni dokumentacionin?.....	6
3.3 Afati i fundit për dërgimin e aplikacioneve	6
3.4 Si të kontaktoni nëse keni ndonjë pyetje?	6

4. VLERËSIMI DHE NDARJA E FONDEVE	6
4.1. Aplikacionet e pranuar do të kalojnë nëpër procedurën e mëposhtme:.....	6
4.2 Dokumentacion shtesë dhe kontraktimi	7
5. Kalendar i indikativ i realizimit të thirrjes.....	8

1. THIRRJE PUBLIKE PËR MBËSHTETJE FINANCIARE PUBLIKE TË INDIVIDËVE DHE OJQ-VE NË PROJEKTET ME AKTIVITETE KULTURORE, SPORTIVE, DHE RINORE NË KOMUNËN E GJILANIT

1.1. Përshkrimi i problemit, i cili synohet të adresohet përmes kësaj thirrje publike

Me qëllim të fuqizimit të sektorit të pavarur sportiv, rinor dhe artistik, duke qenë se në komunën e Gjilanit ka mjaftueshëm artistë, sportistë, dhe rini vitale, Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit përmes kësaj thirrje synon që përmes përkrahjes financiare dhe jo financiare, të mobilizojë artistët, sportistët dhe të rinjtë për begatimin e jetës kulturore, rinore, dhe sportive, me sa më shumë sasi dhe cilësi në Komunën e Gjilanit.

1.2 Fushat e përkrahjes së projekteve:

- Aktivitetet e kalendarit vjetor, të publikuara nga komuna, në kuadër të kësaj thirrje.
- Aktivitetet artistike/ krijuese, të të gjitha formave artistike
- Aktivitetet sportive, të të gjitha disiplinave
- Aktivitetet rinore

1.3 Objektivat e Thirrjes publike

Objektivat e përgjithshme:

- Aktivitetet cilësore të cilat përkojnë me datat e kalendarit vjetor të publikuara nga Komuna e Gjilanit duke e ruajtur formën e tyre të trashëgimisë shpirtërore me një qasje sa më inovative.
- Aktivitetet sa më cilësore në fushën e kulturës, rinisë, dhe sportit, të cilat nuk përkojnë me datat e kalendarit vjetor 2022, të publikuar në kuadër të kësaj thirrje.

1.4 Vlera e planifikuar për projektet kulturore artistike

- Numri i përafërt i kontratave, të cilat do të mund të financohen është 50.
- Shuma minimale për një projekt mund të jetë 500.00 euro ndërsa ajo maksimale për një projekt për OJQ-të, mund të jetë 8,000.00 euro.
- Shuma minimale për një projekt për individ mund të jetë 500.00 euro, ndërsa ajo maksimale, për një projekt për individët mund të jetë 1,500.00.
- Totali i shumës për fushën e sportit është rreth 80,000.00 euro.
- Totali i shumës për fushën e kulturës është rreth 70,000.00 euro.
- Totali i shumës për fushën e rinisë është rreth 25,000.00 euro.

2. KUSHTET FORMALE TË THIRRJES PUBLIKE

2.1. Kush mund të aplikoj?

- Të gjitha organizatat e regjistruara si OJQ (sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për lirinë e asociimit në organizata jo-qeveritare në Republikën e Kosovës apo në shtetin ku është e koncentruar diaspora), si dhe individët, programi i të cilëve është i fokusuar në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, në komunën e Gjilanit.
- OJQ-të ose individët mund të aplikojnë me më shumë se një projekt, në kuadër të kësaj thirrje publike. Periudha e zbatimit të projekteve është më së largu deri me 31.12.2022.

2.2 Shpenzimet e pranueshme që do të financohen për këtë thirrje publike

2.2.1 Shpenzimet e drejtpërdrejta të pranueshme

Shpenzimet sipas kostove të pranueshme direkte përfshijnë shpenzimet që janë drejtpërdrejt të lidhura me zbatimin e disa aktiviteteve të projektit ose të programit të propozuar, të tilla si:

- Organizimi i aktiviteteve kulturore dhe artistike, aktivitetet për avokim, punëtori, tryeza, debate (në mënyrë të veçantë duhet të identifikohet lloji dhe çmimi i secilit shërbim);

- Material shpenzues;
- Shërbime grafike (prepress, shërbimet për shtypjen e fletushkave, broshurave, revistave, etj, duke specifikuar llojin dhe qëllimin e shërbimit, sasinë, çmimin e njësisë, etj.);
- Shërbimet e reklamimit (televizionit dhe radio prezantime, mirëmbajtjes së ueb faqeve, njoftimet në gazeta, materiale reklamuese, etj, duke përcaktuar llojin e promovimit, kohëzgjatjen dhe koston e shërbimeve);
- Shpenzimet e pagesave për stafin e projektit/programit, të kontraktorëve të projektit nga organizatat, individët dhe/ose partnerët e jashtëm të përfshirë në projekt (kontratat e të drejtave të autorit dhe të drejtave pronësore, kontratat tjera, kontratat e punësimit), duke specifikuar emrin e personave të angazhuar, kompetencat e tyre profesionale, numrin e muajve të angazhimit dhe shumën mujore bruto të kompensimit;
- Shpenzimet e komunikimit (shpenzimet e telefonit, internetit, etj) këto shpenzime duhet të jenë të përcaktuara;
- Shpenzimet e transportit dhe udhëtimit;
- Shpenzimet e akomodimit dhe ushqimit (aty ku është e nevojshme duke e specifikuar numrin e njerëzve, destinacionit, qëllimin e udhëtimit dhe llojin e transportit, llojin e akomodimit dhe numrin e netëve);
- Kosto të tjera që lidhen drejtpërdrejt me zbatimin e aktiviteteve të projektit apo programit;

2.2.2 Shpenzimet e papranueshme

Shpenzim i papranueshm përfshihet

- Tejkalmi i shumës totale të pagave për anëtarët e organizatës/ individit, në më tepër se 50% të shumës totale të çdo projekti nuk është i pranueshëm.

3. SI TË APLIKONI?

Aplikimi i OJQ-ve dhe individëve konsiderohet i plotë, nëse përmban të gjitha format e aplikimit dhe anekset e detyrueshme siç kërkohet në paragrafin 3.1 nga ky udhëzim.

3.1. Dokumentacioni i detyrueshëm

1. Çertifikata e regjistrimit të OJQ-së
2. Çertifikata e Nr. Fiskal të OJQ-së
3. Vërtetimi/ konfirmimi bankar i OJQ-së/individit
4. Kopja e letërnjoftimi të përfaqësuesit të OJQ-së/individit
5. Aplikacioni për projekt për OJQ /individë
6. Forma e buxhetit për OJQ/ individë
7. Deklarata mbi financimin e dyfishtë për OJQ/individë

8. Deklarata e partneritetit për OJQ/individë
9. Deklaratë mbi projektet e financuara nga burimet publike të financimit në vitin paraprak për OJQ/individë

Shkarko, dhe plotëso me kompjuter, dokumentacionin (5, 6, 7, 8, dhe 9) brenda thirrjes.

3.2 Ku ta dorëzoni dokumentacionin:

- Format e detyrueshme duhet të jenë të nënshkruara nga përfaqësuesi i autorizuar dhe të vulosura me vulën zyrtare të organizatës. Për individët, kërkohet vetëm nënshkrimi.
- Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen personalisht, në kopje fizike, në adresën e mëposhtme:
- Aplikimi origjinal, duhet të dorëzohet në Qendrën për shërbim me qytetarë, ndërtesa e Soliterit, kati I. Në pjesën e jashtme të zarfit duhet të shënohet emri i plotë i aplikuesit me shënimin: “Të mos hapet para takimit të Komisionit Vlerësues”.

3.3 Afati i fundit për dërgimin e aplikacioneve

Afati për dorëzimin e aplikacioneve është pesëmbëdhjetë (15) ditë pune, nga data: 11.02.2022 deri më 04.03.2022.

3.4. Si të kontaktoni nëse keni ndonjë pyetje?

Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike, mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën dkrs.gjilan@rks-gov.net, jo më vonë se tetë (8) ditë para mbylljes së thirrjes publike.

Të gjitha pyetjen dhe përgjigjet, do të publikohen në ueb faqen e komunës, jo më vonë se tetë (8) ditë para mbylljes së thirrjes.

4. VLERËSIMI DHE NDARJA E FONDEVE

4.1 Aplikacionet e pranuar do të kalojnë nëpër procedurën e mëposhtme:

4.1.1 DKRS-ja do të themelojë një komision vlerësues të përbërë nga 5 anëtarë nga zyrtar të institucionit dhe ekspert tjerë të jashtëm, i cili ka për detyrë të vlerësojë aplikacionet nëse i plotësojnë kushtet formale të thirrjes publike.

Pas kontrollimit të gjitha aplikacioneve të pranuar, komisioni do të përgatis një listë të të gjitha aplikantëve që i plotësojnë kushtet për tu vlerësuar përmbajtja e projekteve të tyre, dhe një listë të aplikantëve të cilët nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara të konkurrencës. DKRS-ja do të njoftojë me shkrim të gjithë aplikantët të cilët nuk i plotësojnë kërkesat dhe arsyet e refuzimit të aplikimit të tyre.

4.1.2 Në fazën e dytë do të bëhet vlerësimi i përmbajtjes së aplikimeve nga ana e Komisionit vlerësues i përbërë nga 5 anëtarë. Çdo aplikacion i pranuar do të vlerësohet në bazë të formularit të vlerësimit

Lista e përkohshme e projekteve/programeve përfituese të përzgjedhura për financim - Në bazë të vlerësimit të aplikacioneve të cilat i kanë plotësuar kushtet e parashikuara të thirrjes, Komisioni do të hartojë një listë të përkohshme të projekteve/programeve të përzgjedhura, sipas pikëve që ata kanë marrë në procesin e vlerësimit.

Krahas listës së përkohshme, bazuar në pikat që janë bërë gjatë vlerësimit, Komisioni do të hartojë edhe listën rezervë të projekteve/programeve.

4.2 Dokumentacioni shtesë dhe kontraktimi

Për të shmangur shpenzimet e panevojshme shtesë kur të aplikoni, DKRS-ja do të kërkojë dokumentacion shtesë vetëm nga ata aplikantë të cilët, në bazë të procesit të vlerësimit të aplikacioneve, kanë hyrë në listën e përkohshme të projekteve të përzgjedhura për financim.

Para nënshkrimit përfundimtar të kontratës, dhe në bazë të vlerësimit të Komisionit, DKRS-ja do të kërkojë shqyrtimin e vijave buxhetore për kostot e vlerësuara që korrespondojnë me shpenzimet aktuale në lidhje me aktivitetet e propozuara. Linjat buxhetore duhet të nënshkruhen nga përfituesi i projektit dhe zyrtari përgjegjës në DKRS.

Komisioni vlerësues do të bëjë kontrollimin e dokumentacionit shtesë.

Nëse përfituesi nuk paraqet dokumentacionin e kërkuar shtesë brenda kohës së caktuar, përfituesi do të refuzohet.

Pas kontrollit të dokumentacionit të paraqitur, komisioni do të propozojë listën përfundimtare të projekteve të përzgjedhura për financim.

Njoftimi i aplikuesve - Të gjithë aplikantët, aplikimet e të cilëve kanë hyrë në procesin e vlerësimit do të jenë të informuar në lidhje me vendimin për financimin e projekteve.

5. Kalendari indikativ i realizimit të thirrjes

Fazat e procedurës së thirrjes:

1. Afati i fundit për aplikimet : 04.03.2022, në ora 16:00.
2. Afati i fundit për dërgimin e pyetjeve në lidhje me thirrjen : 22.02.2022 në ora 16:00.
3. Afati i fundit për dërgimin e përgjigjeve për pyetjet që lidhen me thirrjen : 22.02.2022, në ora 16:00.
4. Afati i fundit për vlerësimin e aplikimeve në mënyrë përmbajtjesore: 21.03.2022, në ora 16:00.
5. Afati i fundit për kërkesën për dorëzimin e dokumenteve shtesë: 23.03.2022, në ora 16:00.
6. Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar: 28.03.2022, në ora 16:00.
7. Afati i fundit për dorëzimin e ankesave: 28.03.2022, në ora 16:00.
8. Afati i fundit për publikimin e vendimit për ndarjen e fondeve publike dhe njoftimi aplikantëve: 04.04.2022, në ora 16:00.

Financuesi ka të drejtë të përditësoj kalendarin indikativ. Duhet të dini se çdo ndryshim në kalendarin indikativ do të publikohet në faqen: <https://kk.rks-gov.net/gjilan/>

Drejtori: Kushtrim Zeqiri